



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/19

Datë: 14.05.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore për nevoja të Ofruesit për Shërbimet e Navigacionit Ajror të Republikës së Kosovës (ish-ASHNA), zonat kadastrale Vrellë e Goleshit dhe Mirenë, Komuna e Lipjanit, Zona Kadastrale Zatriq, Komuna e Rahovecit, Zona Kadastrale Mramor, Komuna e Prishtinës, dhe Zona Kadastrale Bajgorë, Komuna e Mitrovicës së Jugut, sipas tabelës së bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit të punuara nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat e bashkëngjitura këtij Vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit ua dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme, ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar, i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike, kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Subjektit Kërkues/ Ofruesit për Shërbimet e Navigacionit Ajror të Republikës së Kosovës (ish-ASHNA).

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, subjekti kërkues/Ofruesi për Shërbimet e Navigacionit Ajror i Republikës së Kosovës (ish-ASHNA), do ta paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit i cili është pjesë e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
8. Subjekti kërkues/Ofruesi për Shërbimet e Navigacionit Ajror i Republikës së Kosovës (ish-ASHNA), obligohet të bëjë regjistrimin (bartjen) e pronës së shpronësuar në librat kadastralë pas kryerjes së pagesave të pronave të shpronësuar, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
9. Subjekti kërkues/Ofruesi për Shërbimet e Navigacionit Ajror i Republikës së Kosovës (ish-ASHNA), do të bëjë përfaqësimin ligjor në gjykata, për të gjitha pronat e shpronësuar dhe dëmet e tjera, në të gjitha rastet nëse do të ketë inicim të procedurës gjyqësore.
10. Subjekti kërkues/Ofruesi për Shërbimet e Navigacionit Ajror i Republikës së Kosovës (ish-ASHNA) obligohet t'i paguajë plotësisht të gjitha obligimet e tjera financiare që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit dhe vendimeve gjyqësore.
11. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratin e shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Zyra Kadastrale Komunale është e obliguar t'i kryejë veprimet procedurale për zbatimin e tij.
12. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/19
Datë: 14.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 14, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 10/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Financave për ndryshimin dhe plotësimin e pikës 1. të Vendimit të Qeverisë Nr. 04/04, të datës 13 mars 2026, me ç'rast shuma e miratuar prej 370,000.00€ (treqind e shtatëdhjetë mijë eurosh) rritet për 3,150.90€ (tremijë e njëqindpesëdhjetë euro e nëntëdhjetë centë), duke arritur vlerën totale prej 373,150.90€ (treqind e shtatëdhjetë mijë e njëqindpesëdhjetë euro e nëntëdhjetë centë), për Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim (International Development Association - IDA), me qëllim të mbulimit të diferencës së krijuar nga luhatjet në kursin valutor.
2. Mjetet shtesë në shumën prej 3,150.90€ (tre mijë e njëqindpesëdhjetë euro e nëntëdhjetë centë), sipas pikës 1. të këtij Vendimi, merren nga Ministria e Financave, me kod 201, nga nënprogrami "Kontigjencat në Ministrinë e Financave", me kod 28900, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe transferohen në Ministrinë e Financave, me kod 201, në nënprogramin "Thesari", me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/19
Datë: 14.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 2. e Vendimit të Qeverisë Nr. 22/39, të datës 13 tetor 2021, si në vijim:
2. Komisioni Ministror do të përbëhet nga:
 - 2.1. Ministri për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare;
 - 2.2. Ministri i Sportit dhe Rinisë;
 - 2.3. Ministri i Arsimit dhe Shkencës;
 - 2.4. Ministri e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit;
 - 2.5. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal.
3. Pikat e tjera të Vendimit Nr. 22/39, të datës 13.10.2021, mbesin të pandryshuara.

A r s y e t i m

Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit Nr. 22/39, të datës 13.10.2021, bëhet për shkak se me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, kanë ndryshuar fushat e përgjegjësisë të ministrive.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/19
Datë: 14.05.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Ministror për Skemën Evropiane të Garancisë për Fëmijë (tutje referuar si Komisioni Ndër-Ministror).
2. Komisioni Ministror do të përbëhet nga:
 - 2.1. Ministri i Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare;
 - 2.2. Ministri i Financave;
 - 2.3. Ministri i Arsimit dhe Shkencës;
 - 2.4. Ministri i Shëndetësisë;
 - 2.5. Zyra për Qeverisje të Mirë/ZKM.
3. Komisioni Ministror është mekanizëm mbikëqyrës ndër-institucional dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e implementimit të skemës së garantuar për fëmijë, në përputhje me udhëzimin e BE-së.
4. Komisioni Ministror kryesohet nga Ministri për Punë, Familje dhe Vlera të Luftës Çlirimtare, në rast të mungesës së tij, ai e autorizon një zyrtar tjetër shtetëror si zëvendësues.
5. Komisioni Ministror, i emëruar me këtë Vendim, ka për detyrë të takohet më së paku dy herë në vit, si dhe në afate më të shkurtra kohore, nëse ekzistojnë nevojat dhe/ose shkaqet për takime të tilla.
6. Kryesuesi i Komisionit do të emërojë një ekip teknik, në përbërje të ekspertëve nga institucionet përkatëse, të cilët do të jenë përgjegjës për hartimin dhe përpilimin e planit, kriterëve dhe procedurave për dizajnimin e skemës, në përputhje me rregullat e përcaktuara me udhëzimet e BE-së, si dhe në mbështetje me legjislacionin në fuqi.
7. Obligohen të gjitha ministritë dhe institucionet e tjera që janë pjesë e administratës shtetërore nën autoritetin e Qeverisë që të ofrojnë bashkëpunim dhe ndihmë në të gjitha rastet kur kjo kërkohet nga ana e Komisionit Ndër-Ministror.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/19
Datë: 14.05.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë në Shëndetin në Punë, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Nacional për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (KNSSHP), në këtë përbërje:
 - 1.1. Andin Hoti, Ministër për Punë, Familje dhe Vlera të Luftës Çlirimtare;
 - 1.2. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë;
 - 1.3. Kastriot Jashari, Inspektorati Qendror i Punës;
 - 1.4. Tevide Imeri, përfaqësuese e të punësuarve;
 - 1.5. Blendor Shatri, përfaqësues i të punësuarve;
 - 1.6. Elza Luzha, përfaqësuese e punëdhënësve;
 - 1.7. Anila Pishtari, përfaqësuese e punëdhënësve;
 - 1.8. Myhedin Shehu, ekspert i mjekësisë së punës;
 - 1.9. Mimoza Dugolli, eksperte nga fusha e sigurisë dhe e shëndetit në punë;
 - 1.10. Burim Islami, ekspert nga fusha e sigurisë dhe e shëndetit në punë;
 - 1.11. Ekspert ad-hoc, sipas rastit.
2. Mandati i anëtarëve të Këshillit nga pika 1. e këtij Vendimi është tri (3) vjet.
3. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe Rregulloren (QRK) Nr. 14/2014 për përcaktimin e rregullave dhe procedurën e punës së Këshillit Nacional për sigurinë dhe shëndetin në punë.
4. Obligohen Ministria për Punë, Familje dhe Vlera të Luftës Çlirimtare dhe institucionet e tjera të Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/19
Datë: 14.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet miratimi i zgjatjes së Planit të Implementimit të Skemës për Garancinë për të Rinjtë 2026.
2. Vazhdim i zbatimit të reformave dhe iniciativave ekzistuese gjatë vitit 2026, duke përfshirë edhe futjen e masave të reja dhe rishikime të vogla që lidhen me objektivat dhe afatet kohore.
3. Obligohet Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/19
Datë: 14.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafi 1, të Ligji Nr. 08/L-219 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-172, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë për themelimin e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar Gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, Nr. 06/143, i datës 28 prill 2017, i ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimin Nr. 02/54, të datës 12 janar 2022, dhe Vendimin Nr. 12/214, të datës 24 korrik 2024, riformulohet si në vijim:
 - Pika 1.6 e Vendimit të Qeverisë Nr. 06/143, të datës 28 prill 2017, riformulohet: Në vend të z. Feride Podvorica, nga Ministria e Drejtësisë, emërohet znj. Artë Ademi - Bajrami, Udhëheqëse e Divizionit për Qasje në Drejtësi, Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Gruas dhe Dhuna në Baza Gjinore.
 - Pika 1.9 e Vendimit Nr. 12/214, të datës 24 korrik 2024, riformulohet: në vend të z. Kreshnik Oseku, emërohet znj. Arbëresha Tetaj, nga Ministria për Punë, Familje dhe Vlera të Luftës Çlirimtare.
2. Obligohen Ministria për Punë, Familje dhe Vlera të Luftës Çlirimtare dhe të gjitha institucionet e tjera që janë të përfshira sipas legjislacionit, për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/19
Datë: 14.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-198 për Tregtinë me Mallra Strategjike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet përditësimi i Listës Shtetërore Strategjike për Mallra Ushtarake, duke iu referuar Listës së Bashkimit Evropian, për mallrat që vihen nën kontroll për shkaqe të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, sigurisë publike, ose për arsye të të drejtave të njeriut.
2. Kjo listë përkon me pozicionin e përbashkët të Këshillit të BE-së 2008/944CFSP, që përcakton mallrat e përbashkëta që rregullojnë kontrollin e eksporteve të teknologjisë dhe pajisjeve ushtarake. Kjo listë është e përditësuar dhe e zëvendëson Listën e përbashkët Ushtarake të BE-së, të miratuar nga Këshilli më 24 shkurt 2025, C/2025/1499.
3. Obligohen Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit dhe institucionet e tjera kompetente për zbatim të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/19
Datë: 14.05.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i Projektit "Qarkorja e Vjetër e Qytetit të Gjilanit", Llot 1 dhe Llot 2, zonat kadastrale Shillovë, Livoç i Ulët dhe Gjilan, Komuna Gjilan, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit, të punuara nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, dhe tabelat e bashkëngjitura këtij Vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit ua dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme, ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit në pajtim me legjislacionin në fuqi.
8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratin e shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria për Kadastër e Komunës përkatëse është e obliguar t'i kryejë veprimet procedurale për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/19
Datë: 14.05.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i Projektit "Rehabilitimi, zgjerimi dhe asfaltimi i Rrugës Nacionale R118, segmenti brenda fshatit Mushtisht, zona kadastrale: Mushtisht, Komuna e Suharekës", sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit të punuara nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat e bashkëngjitura këtij Vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit ua dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratin e shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastrale në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria për Kadastër e Komunës përkatëse është e obliguar t'i kryejë veprimet procedurale për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/19

Datë: 14.05.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i projektit për zgjerimin e mihjes sipërfaqësore për eksploitim të thëngjillit për prodhim të energjisë elektrike për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK Sh. A.), zonat kadastrale: Siboc, Shipitullë, Leshkoshiq, Hade dhe Palaj, Komuna Obiliq, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit të punuara nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat e bashkëngjitura këtij Vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit ua dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës, pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme, ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike, kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e subjektit kërkues/Korporata Energjetike e Kosovës (KEK- Sh. A).
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, subjekti kërkues/Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh. A), do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit i cili është pjesë e këtij Vendimi.
8. Subjekti kërkues/Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh. A.) do t'i paguajë plotësisht të gjitha obligimet e tjera financiare që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit dhe vendimeve gjyqësore.
9. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratin e shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi dhe pas marrjes së konfirmimit nga subjekti kërkues për kryerjen e pagesës së pronave, Drejtoria për Kadastër e komunës përkatëse është e obliguar t'i kryejë veprimet procedurale për zbatimin e tij.
10. Pronat e shpronësuara, sipas këtij Vendimi Përfundimtar, pas kompensimit të pronave, do të barten/regjistrohen në kadastër në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës - shfrytëzues Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh. A.), në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205.
11. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/19

Datë: 14.05.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i Kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore, të menaxhuara dhe të administruara nga AKP-ja, të cilat janë të nevojshme për realizimin e projekteve të mëposhtme të Komunës së Podujevës:
 - Ndërtimi i Fushës dhe i Hapësirave Sportive dhe Rekreative në Fshatin Pakashticë e Poshtme, zona kadastrale: Pakashticë e Poshtme, Komuna e Podujevës;
 - Ndërtimi i Fushës dhe i Hapësirave Sportive dhe Rekreative në Fshatin Revuç, zona kadastrale: Revuç, Komuna e Podujevës;
 - Zgjerimi dhe Rregullimi i Hapësirës së Ambulancës së Mjekësisë Familjare në Fshatin Bajqinë, zona kadastrale: Bajqinë, Komuna e Podujevës;
 - Zgjerimi dhe Rregullimi i Hapësirës së Ambulancës së Mjekësisë Familjare në Fshatin Dumnicë e Poshtme, zona kadastrale: Dumnicë e Poshtme, Komuna e Podujevës;
 - Zgjerimi i Hapësirës për Ndërtimin e Objekteve Kolektive të Banimit Social, zona kadastrale: Surkish, Komuna e Podujevës; dhe
 - Realizimi i shpronësimit të lokalit afarist ish-NSH "Bankos" për nevoja të ushtrimit të veprimtarisë së Ndërmarrjes Publike-Lokale "Eko-Llapi", zona kadastrale: Podujevë, Komuna e Podujevës.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, në pajtim me nenin 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet e tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe i vlerësimit do të bëhet nga buxheti i subjektit kërkues/Komuna e Podujevës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor), Ministria e Financave dhe subjekti kërkues/Komuna e Podujevës.
6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/19
Datë: 14.05.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i Kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore, të menaxhuara dhe të administruara nga AKP-ja, të cilat janë të nevojshme për realizimin e projekteve të mëposhtme të Komunës së Podujevës:
 - Realizimi i Projektit për Ndërtimin e Tregut të Kafshëve, zona kadastrale Dumnicë e Poshtme, Komuna e Podujevës;
 - Realizimi i Projektit për Ndërtimin e Tregut të Gjellbër, zona kadastrale Podujevë, Komuna e Podujevës.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, në pajtim me nenin 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet e tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe i vlerësimit do të bëhen nga buxheti i subjektit kërkues/Komuna e Podujevës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor), Ministria e Financave dhe subjekti kërkues/Komuna e Podujevës.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/19

Datë: 14.05.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i Kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore, të menaxhuara dhe të administruara nga AKP-ja, të cilat janë të nevojshme për realizimin e projekteve të mëposhtme të Komunës së Podujevës:
 - Realizimin e Projektit për Ndërtimin e Banesave me Kosto të Përbalueshme, zona kadastrale Podujevë, Komuna e Podujevës dhe
 - Objektet Edukativo-Arsimore-Çerdhe për Fëmijë, zona kadastrale: Podujevë, Komuna e Podujevës.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit, që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, në pajtim me nenin 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet e tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe i vlerësimit do të bëhet nga buxheti i subjektit kërkues/Komuna e Podujevës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor), Ministria e Financave dhe subjekti kërkues/Komuna e Podujevës.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/19
Datë: 14.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, Ligji Nr. 08/L-193, nenit 14, pika 6, dhe nenit 13, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej 50,000.00€ (pesëdhjetë mijë eurosh), në Ministrinë e Kulturës dhe Turizmit, me kod 207, për zbatimin e programit "Masat preventive - intervenime emergjente" nëpër komuna të ndryshme.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi rialokohen nga nënprogrami "Mbrotja, Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore", me kod 81500, nga kategoria e shpenzimeve kapitale, përkatësisht projekti "Masat preventive - intervenime emergjente", me kod 12688, rialokohen në projekt të ri, sipas shumës së cekur:
 - 2.1. Rikonstruktimi i xhamisë së djegur të Ibrit - Xhamia e Boshnjakëve, Mitrovicë e Veriut, në shumë prej 50,000.00€ (pesëdhjetë mijë eurosh).
3. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës dhe Turizmit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/19
Datë: 14.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për rialokim të mjeteve buxhetore në shumë prej 1,000,000.00€ (një milion eurosh), deri në 25% të ndarjes së ndikuar negativisht, të vlerës totale të kategorisë së shpenzimeve "Investime Kapitale", të aprovuar për nënprogramin "Administrata Qendrore".
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi, merren nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kodi 212, nga nënprogrami "Administrata Qendrore", kodi 11312, nga kategoria e shpenzimeve "Investime Kapitale", nga projekti "Programi për Grantin e Performancës Komunale", me kod 20659, (shuma e ndikuar negativisht është - 24.69 %), dhe rialokohen në projektin "Programi Komunal për Zhvillim të Infrastrukturës Socio-Ekonomike dhe Bashkëpunim Ndër-Komunal", me kod 15633.
3. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/19
Datë: 14.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 28 të Ligjit Nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 05/220, të datës 11 shtator 2024, i ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimin Nr. 09/280, të datës 12 dhjetor 2025

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 05/220, i datës 11 shtator 2024, i ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimin Nr. 09/280, të datës 12 dhjetor 2025, si në vijim:
 - Në vend të z. Jetish Maloku, përfaqësues i Këshilli Prokurorial të Kosovës, emërohet z. Visar Krasniqi, anëtar në Këshillin Prokurorial.
2. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 05/220, të datës 11 shtator 2024, dhe Vendimit të Qeverisë Nr. 09/280, të datës 12 dhjetor 2025.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/19
Datë: 14.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

- Qeveria e Republikës së Kosovës për Drejtor të Bordit të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Korporata e Ruajtjes së Energjisë - KRE" (Energy Storage Corporation - ESCorp), emëron këta kandidatë:
 - Bujar Haxha, kryesues;
 - Fisnik Musai, anëtare;
 - Violeta Arifi - Krasniqi, anëtare;
 - Mimoza Byqmeti, anëtare.
- Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi i kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111, Ligjin nr. 05/L-009 dhe me dispozitat e tjera në fuqi.
- Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij Vendimi zgjat tri (3) vjet.
- Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/19
Datë: 14.05.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore KBI Ereniku, për nevoja të realizimit të projektit: "Ndërtimi i Zonës Industriale të Mbrojtjes", zona kadastrale: Jahoc, Komuna e Gjakovës, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit të punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat të bashkëngjitura këtij Vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit komfor legjislationit në fuqi.
8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria për Kadastër e Komunës përkatëse është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/19
Datë: 14.05.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 22, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 10/L-001 për Ndarjet Buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2026, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19, të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i plotësuar dhe i ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31, të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49, të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62, të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90, të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 31/99, të datës 30.09.2022, Vendimin Nr. 20/140, të datës 26.04.2023, Vendimin Nr. 23/159, të datës 13.09.2023, Vendimin Nr. 42/178, të datës 13.12.2023, Vendimin Nr. 43/178, të datës 13.12.2023, Vendimin Nr. 01/241, të datës 27.12.2024, dhe Vendimin Nr. 02/270, të datës 07.10.2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa për ndarjen e mjeteve buxhetore, në shumë prej 1,000,000.00€ (një milion eurosh), për zbatimin e Masës 1.9 - Mbështetja e punësimit të personave nga komunitetet joshumicë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet e ndara, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, merren nga Ministria e Financave, me kod 201, nga nënprogrami "Programi i Ringjalljes Ekonomike", me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, me kod 211, në nënprogramin "Administrata Qendrore", me kod 11311, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet, sipas këtij Vendimi, transferohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098), në nënprogramin përkatës, për realizimin e subvencioneve për përfituesit e përzgjedhur, në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me vendime të veçanta të Ministrit për Komunitete dhe Kthim.
4. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/19
Datë: 14.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 24, paragrafët 1, dhe 2, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 90,599.56€ (nëntëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetenëntë euro e pesëdhjetegjashtë centë) për Komunën e Podujevës, për përfundimin e projektit "Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë" përmes Klauzolës së Investimeve (fondi burimor 06).
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, me kod 201, nga nënprogrami "Huamarrja për projekte potenciale brenda MFPT", me kod 48900, nga kategoria e shpenzimeve "Investime Kapitale", nga projekti "Kontigjenca për Klauzolë të Investimeve", me kod 15045, dhe transferohen në Komunën e Podujevës (615), në nënprogramin "Infrastruktura Publike", me kod 18165, në projektin "Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë", me kod 49125, në kategorinë e shpenzimeve "Investime Kapitale"- përmes Klauzolës së Investimeve (fondi burimor 06).
3. Obligohen Ministria e Financave dhe Komuna e Podujevës për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 22/19
Datë: 14.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 24, paragrafi 4, i Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit për rritjen e kufirit të shpenzimeve, në shumë prej 15,000,000.00€ (pesëmbëdhjetë milionë euro), për projektin "Rehabilitimi i Linjës X Hekurudhore (Fushë Kosovë - Hani i Elezit)", nga fondet e huamarrjes "Klauzola e Investimeve".
2. Mjetet buxhetore, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, alokohen në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, me kod 205, në nënprogramin "Departamenti i Transportit të Përgjithshëm", me kod 45900, në kategorinë e shpenzimeve "Investime Kapitale", për projektin "Rehabilitimi i Linjës X Hekurudhore (Fushë Kosovë - Hani i Elezit)", me kod 15046, nga burimi i financimit të huamarrjes "Klauzola e Investimeve 06".
3. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë